




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës (FK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Fushë Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 818,159€.
- B2 Prezantim jo i plotë dhe jo i saktë i pasurive në PVF, për shkak të nënvlerësimit për 428,750€, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PVF.
- A1 Prezantim jo i plotë dhe jo i saktë i detyrimeve kontigjente në PVF në vlerë prej 244,030€.
- A2 Prezantim jo i plotë dhe jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 2,971€.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Fushë Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A3 Komuna kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik (OE) i cili nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuar në dosje të tenderit.
- B3 Në pesë (5) pagesa të testuara në vlerë 183,105€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.
- B4 Si pasoj e vonesës në pagesën e detyrimeve financiare komuna ishte detyruar të paguante shpenzime shtesë në vlerë prej 171,556€ në emër të procedurës kontestimore/përmbartimore apo interesit për pagesë të vonuar.
- B5 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme.
- B6 Komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit.
- B7 Komuna gjatë vitit 2023, nuk kishte arrit që ti përfshinte në listën e pagave 42 të punësuar, të cilët kishin kontrata të rregullta të punës.
- B8 Në një (1) rast, komuna kishte bërë ndryshime të kontratave duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor prej 10%.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Fushë Kosovës.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Fushë Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Fushë Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Fushë Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Fushë Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm financiar dhe të pajtueshmërisë, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësitë e evidentuara janë vërejtur në fushat të rëndësishme financiare si: Prezantim jo i saktë llogarive të arkëtueshme, pasurive jo financiare dhe i detyrimeve kontingjente në PVF, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera, mungesa e projekteve ekzekutues, ndryshimi i kontratave të prokurimit duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor, dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore, etj. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 20 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja dhe 13 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

##### Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në 21<sup>5</sup> raste kemi identifikuar se komuna kishte ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate në vlerë prej 818,159€ si:

- Nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 68,759€ ishin paguar për investime kapitale dhe 98,060€ ishin paguar për paga dhe mëditje.
- Nga kategoria e investimeve kapitale vlera prej 381,048€ ishin paguar për mallra dhe shërbime, 213,143€ për subvencione dhe transfere si dhe 5,633€ për paga dhe mëditje sipas kontratës kolektive.
- Nga kategoria subvencioneve dhe transfereve vlera prej 7,855€ ishin paguar për investime kapitale dhe 43,661€ ishin paguar për paga dhe mëditje për punëtorët që ishin jashtë listës së pagave.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse si dhe shkak të pagesave të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore.

**Ndikimi** Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

#### **Çështja B2 - Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PVF**

**Gjetja** Sipas Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 6, "Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Komuna në gjashtë (6)<sup>e</sup> raste në vijim, nuk kishte regjistruar pasuritë në SIMFK apo e kishte regjistruar gabim dhe atë në vlerë 428,750€:

- Pasuria kapitale ishte nënvlerësuar për 234,560€, për shkak se disa nga blerjet e vitit 2023 nuk ishin regjistruar në SIMFK si: Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Sllatinë e Vogël, Renovimi i objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Furnizim me projektor dhe pajisje përcjellëse për shkolla publike, filllore dhe të mesme, etj;
- Pasuria kapitale ishte mbivlerësuar për 194,190€ pasi që pasuria nën 1000€ ishte regjistruar gabim në SIMFK.

Mos funksionimi i kontrolleve dhe mungesa e komunikimit të mirëfilltë mes departamenteve ishin shkaktarët kryesor të mos regjistrimit të plotë të pasurisë.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i të gjitha pasurive, rrit rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll të gjitha pasuritë e saj, dhe të ketë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në PVF.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të rrisë performancën e angazhimit tek stafi dhe përmirësoj komunikimin në mes drejtorive, që të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë, në mënyrë që të ulet rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I



**Çështja A1 - Prezantim jo i plotë dhe jo i saktë i detyrimeve kontigjente në PVF****Gjetja**

Sipas nenit 6 të Rregullores MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Komuna në pesë (5)<sup>7</sup> rastet në vijim, ka bërë prezantim jo të drejtë të detyrimeve kontigjente në PVF për 244,030€:

- Detyrimet Kontigjente janë mbivlerësuar për 226,298€, nga të cilat 218,725€ janë si shkak i prezantimit të një lënde në regjistrin e detyrimeve kontigjente e cila ka qenë vendim gjyqësor i formës së prerë, për të cilën komuna nuk kishte ushtruar ankesë në nivele më të larta, dhe 7,573€ si pasojë e mos azhurnimit të regjistrit të detyrimeve kontigjente.
- Detyrimet Kontigjente janë nënvlerësuar për 17,732€, nga të cilat 11,233€ janë si shkak i mos shpalosjes së lëndës në regjistrin e detyrimeve kontigjente sipas ekspertizës financiare gjyqësore të fundit, dhe 6,499€ janë si pasojë e shpalosjes së lëndëve në regjistrin e detyrimeve kontigjente me vlerë të papërcaktuar.

Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i detyrimeve kontingjente në PVF kishte ndodhur për shkak se personat përgjegjës nuk kishin azhurnuar vlerën e detyrimeve kontingjente të prezantuar në raport e pastaj edhe në PVF.

**Ndikimi**

Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të plota dhe jo të sakta ndikon në mbivlerësimin apo nënvlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve që komuna pritet të ketë në të ardhmen.

**Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të siguroj se detyrimet kontingjente prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A2 - Prezantim jo i plotë dhe jo i saktë i llogarive të Arkëtueshme në PVF****Gjetja**

Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”. Dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10 paragrafi 1 përcakton se: “Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: pika 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës.

Komuna ka bërë prezantim jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF duke mbivlerësuar regjistrin e llogarive të arkëtueshme për 2,971€, për shkak se kishte bërë ngarkimin me tatim në pronë për katër (4) pronave të paluajtshme të cilat janë në pronësi të komunës.

Kjo kishte ndodhur për shkak se nuk ishin vendosur kontrole adekuate tek monitorimi i ngarkesa sipas kërkesave ligjore.

**Ndikimi**

Prezantimi i llogarive të arkëtueshme në vlerë jo të plotë dhe jo të saktë, ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën llogarive të arkëtueshme.

**Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të plota dhe të sakta për llogaritë e arkëtueshme, duke larguar pronat komunale nga tatimi për të i shmangur mbivlerësimin të llogarive arkëtueshme në të ardhmen.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A3 - Përzgjedhja e operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm, gjatë vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit

**Gjetja** Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Gjithashtu 26.4 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. Në përputhje me këtë nen, secili anëtarë i grupit duhet të dorëzojë së bashku me tenderin e tyre Deklaratën nën Betim dhe në rast se autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënien e kontratës grupit në fjalë, secili anëtar i grupit duhet t'i sjellë vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë në përputhje me nenin 65 të LPP-së të specifikuar në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dhe sipas nenit 26.6 Rregullores nr. 001/2022, Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.

Komuna për vendosjen e kamerave për të rritur nivelin e sigurisë në Fushë Kosovë dhe në fshatra, kishte lidhur kontratë me vlerë 498,369€. Sipas dosjes së tenderit të datës 13.04.2023 dhe njoftimit për informata shtesë ose korrigjim të gabimit të datës 14.04.2023, kërkesë e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2: OE duhet të ofroj certifikatat si në vijim: a) ISO 9001:2015, b) ISO 14001:2015 , c) ISO 45001:2018. Ne kemi vërejtur se OE fitues, në listën e çertifikatave ISO të ofruara kishte siguruar vetëm ato të partnerit të dytë të koncorziumit, por jo edhe të partnerit të parë. Pra, lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomik të shpërblyer me kontratë nuk i kishte bashkangjitur në dosjen e ofertës për këtë tender çertifikatat e ISO standardeve siç kërkohen në dosje të tenderit dhe në Rregulloren e KRPP-së Nr. 001/2022 të prokurimit Publik që thotë se të gjithë anëtarët e grupit duhet që ti plotësojnë të gjitha kriteret e pajtueshmërisë profesionale.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e vlerësimit jo korrekt apo mos kompetencës së komisioneve të vlerësimit, për t'i vlerësuar me kujdes ofertat dhe për t'i analizuar dëshmitë e ofruara në raport me kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit. Po ashtu për raste të caktuara, mos aplikimi i qartë i specifikave që duhet t'i plotësojnë anëtarët e grupit duke përcaktuar dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre.

**Ndikimi** Kontraktimi i OE pa i përmbushur kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, eliminon mundësinë e një procesi të mirëfilltë të prokurimit, i cili mund të përjashtoj nga procesi OE të përgjegjshëm dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat

ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### **Çështja B3 - PAGESA TË PROJEKTEVE NGA BUXXHETI I PROJEKTEVE TJERA**

#### **Gjetja**

Sipas nenit 16 pikës 11 të Ligjit Nr. 08-L-193 Ndarjet buxhetore për vitin 2023, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF. Nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Në pesë (5) pagesa të testuara në vlerë prej 183,105€ për katër projekte: Blerja e folive me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës, Blerja e Serave me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës, Blerja e moto kultivatorëve me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës, Blerja e mekanizmit bujqësor me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës, kemi identifikuar se komuna ka përdorur fondet për projekte tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar/buxhetuar. Në këto raste, nuk ka pasur aprovim nga Kuvendi Komunal për ridestinim të fondeve dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Komuna nuk ka ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore. Megjithëse, kjo situatë është përsëritur, veprimet e tilla janë të ndikuara nga planifikimi jo i mirë i projekteve.

#### **Ndikimi**

Përdorimi i fondeve për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin buxhetuar pa një aprovim paraprak nga kuvendi komunal dhe ministri i financave, përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit, ndikon që të devijohen projektet nga ato të aprovuara në kuvendin komunal, në të cilin janë diskutuar dhe aprovuar prioritetet e qytetarëve.

#### **Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore**

**Gjetja** Sipas nenit 39.1 të Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit i cili parasheh se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në 14<sup>8</sup> raste, faturat në vlerë prej 314,888€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave arrinin deri 126 ditë kalendarike.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksojmë se nga analiza e raportit të shpenzimeve rezulton se vonesat në kryerjen e obligimeve financiare kanë shkaktuar shpenzime shtesë përmes proceseve gjyqësore/përmbartimore. Këto pagesa janë realizuar nga buxheti i komunës për vitin 2023, në një vlerë prej 1,076,751€. Nga kjo vlerë, 905,195€ ishte borxhi kryesor i papaguar, ndërsa 171,556€ janë shpenzime shtesë të realizuara për proceset kontestimore / përmbartimore ose interesat e tjera të përfshira.

Kjo kishte ndodhur për shkak të hyrjes në obligime financiare pa pasur fonde buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

**Ndikimi** Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, kanë ndikuar që komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh me qëllim të mos ketë shpenzime shtesë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja B5 - Mos inspektimi i 20% të pronave komunale**

**Gjetja** Sipas nenit 15 të Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Komuna nuk ka bërë inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, Komuna kishte arritur të realizonte verifikim e vetëm 7% të pronave.

Komuna nuk ka ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet alternative për verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme/objekteve.

**Ndikimi** Mos inspektimi i pronave, rezulton me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të

paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B6 - Mungesa e projektit ekzekutues në dosjen e tenderit**

**Gjetja** Sipas nenit 19, paragrafit 17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Komuna ka filluar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur kontrata për projektet si në vijim, pa u hartuar paraprakisht projektet ekzekutive:

- Ndërtimi i shkollës fillore në rrugën Amir Elmazi në Fushë Kosovë, me një vlerë prej 587,119€;
- Ndërtimi i urës këmbësorike metalike në fshatin Grabovc, me një vlerë prej 56,997€;
- Rregullimi i parkut tek pishat në Sllatinë të vogël, me një vlerë prej 242,838€;
- Ndërtimi i objektit të qendrës së mjeksisë familjare në fshatin Miradi e Poshtme, me një vlerë prej 106,882€.

Zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungesë të projektit ekzekutues ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve nga njësitë kërkuese, pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit, duke i zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

**Ndikimi** Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj në realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të shkaktojë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprakisht të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B7 - Zyrtarë jashtë listës së pagave**

**Gjetja** Sipas Rregullës financiare të MF-së Nr. 01-2013, neni 33 parasheh që Organizata Buxhetore duhet të siguroj që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave. Po ashtu edhe Ligji Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e RKS për vitin 2023, neni 12.1 përcakton: Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkaloj numrin e të punësuarve në nivel të nën-programit, në asnjë kohë gjatë viti fiskal 2023, siç specifikohet në tabelën 3.1, 3.1A dhe 4.1 të bashkangjitura në këtë ligj, përveç lehonive në sistemin shkollor para universitar.

Komuna në vitin 2023, kishte angazhuar 42 punonjës jashtë listës së pagave, pasi që komuna kishte tejkuluar numrin e aprovuar të pozitive të punës. Këta punonjës kishin pozita të rregullta të arsimit, si dhe për zëvendësimin e punonjësve të arsimit, e të cilit ishin punësuar sipas procedurave që kërkohen me Ligjin për Zyrtar Publik. Këta punonjës komuna i kishte paguar nga subvencionet.

Sipas zyrtareve të komunës, kishte ndodhur për shkak të rritjes së numrit të nxënësve për vitin shkollor 2023/2024, mungesa me arsye të mësimdhënësve dhe pushimet e lehonisë. Më tutje, mungesa e zyrtarëve në lisën e pagave, është edhe për shkak se, është tejkuluar buxheti dhe numri i lejuar sipas Ligjit të Buxhetit.

**Ndikimi** Mos përfshirja e punonjësve në listën e pagave, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara si dhe vonesat e pagesave rrisin rrezikun e shpenzimeve shtesë përmes procedurave gjyqësore/përmbartimore.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B8 - Ndryshimi i kontratave të prokurimit duke tejkuluar limitin e lejuar ligjor**

**Gjetja** Sipas Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 71.12 Modifikimi duhet të konsiderohet si thelbësor kur plotësohen një ose më shumë nga katër kushtet, si më poshtë: d) Në rast se ndryshimi i propozuar i kontratës përfshin furnizimet, shërbimet apo punët të një cilësie tjetër nga ajo që ishte përcaktuar në kontratën fillestare do të konsiderohet ndryshim thelbësor, kur: (i) Ndryshimet në kontratë tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës në rastin e kontratave publike për furnizim, shërbime dhe punë shtesë.

Te kontrata Renovimi i shkollave fillore të mesme të ultë në Fushë Kosovë dhe fshatra në vlerë 242,242€, ku ishin të përfshira disa shkolla, me kërkesë të menaxherit të kontratës ishin bërë ndryshime të sasive nëpër pozicione në vlerë prej 55,657€ apo 22% të vlerës së kontratës.

Aprovimet për gjitha ndryshimet e cekura më lartë ishin marr nga Zyrtari Kryesor Administrativ, por kishin tejkuluar limitin e lejuar ligjor të ndryshimeve prej 10%.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrollit në zbatimin e kushteve të përcaktuara ligjore dhe inicimit të procedurave të prokurimit dhe lidhja e kontratave për projekte ndërtimore është bërë pa një plan detal ekzekutiv të ndërtimit.

**Ndikimi**

Ndryshimet thelbësore në kontratën për renovimin e objekteve, që tejkalojnë kufirin ligjor prej 10%, rrezikojnë pajtueshmërinë ligjore të procesit të prokurimit, tregon se planifikimi dhe përgatitjet e dosjes së tenderit kanë dobësi të theksuara që ndikon në rritjen e obligimeve të paplanifikuara.

**Rekomandimi B8**

Kryetari duhet të sigurojë që para nënshkrimit të kontratave për projekte ndërtimore të hartohet një plan i detajuar ekzekutiv. Gjithashtu, duhet të sigurohet që çdo ndryshim në kontratë të jetë brenda kufijve të lejuar ligjor për të parandaluar tejkalimet e paautorizuara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 3,438,467€, prej tyre ishin shpenzuar 2,969,599€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me komunalit, barna për QKMF, furnizim me lëndë djegës për ngrohje, derivate për vetura dhe shërbime kontraktuese tjera.

#### **Çështja A4 - Realizimi i vizitave jashtë vendit jo në harmoni me ftesën e pranuar nga institucioni pritës.**

##### **Gjetja**

Sipas ftesës për bashkëpunim të datës 16.10.2023 nga Bashkia e Durrësit, përkatësisht Drejtoria e Turizmit, ishte ftuar administrata komunale e komunës së Fushë Kosovës t'ju bashkëngjiten festimeve në kuadër të festës së Pavarësisë dhe Çlirimit të vendit në muajin Nëntor të vitit 2023.

Komuna kishte paguar 14,500€ për vizitën e 116 zyrtarëve të administratës komunale në Durrës sipas ftesës, për nderë të festave të Nëntorit. Përkundër që ftesa ishte bërë me qëllim të realizimit të vizitës kushtuar aktiviteteve për shënimin e festave të Pavarësisë dhe Çlirimit në Republikën e Shqipërisë dhe atë në muajin Nëntor, vizitën e njëjtë, komuna e kishte realizuar në datat 20.10.2023 deri 22.10.2023. Ne nuk kemi pranuar dëshmi se ditët e qëndrimit në Durrës korrespondojnë me qëllimin për të cilin ishin ftuar stafi i administratës komunale.

Realizimi i vizitës jo në konsistencë me ftesën ishte si pasoje e funksionimit jo efektive të kontrolleve.

##### **Ndikimi**

Shpenzimi i parasë publike jo në konsistencë me procedurat, ftesat e pranuar rritë rrezikun që mjetet e shpenzuara të mos shërbejnë për qëllime të miratuara publike.

##### **Rekomandimi A4**

Kryetari duhet të sigurohet që shpenzimi i buxhetit të destinuar për vizita jashtë vendit të shfrytëzohet drejtë dhe për qëllimet specifike për çka edhe iniciohen procedurat.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,600,643€, prej tyre në 2023 ishin shpenzuar 1,481,331€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimi e fermerëve, OJQ-ve dhe personave fizik në nevojë.

### Çështja A5 - Subvencionimi i individëve jo në pajtim me Rregulloren komunale

**Gjetja** Sipas Rregullore komunale për ndarjen e subvencioneve me numër të protokollit 83 dhe datë 14.06.2013, përkatësisht neni 12 dhe 13 i rregullore parasheh se Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara, ndan ndihmë momentale nga fondi për subvencione dhe transfere i Komunës për raste emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, varfëri të skajshme për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm dhe atë deri në shumën 2,000€.

Komuna kishte ekzekutuar pagesë në vlerë prej 4,000€ personit fizik, me destinim organizimin e festës me rastin e shpalljes kampion në Ligën e Parë dhe inkuadrimit në Super ligën e Kosovës të Klubit të Futbollit "Fushë-Kosova" në Fushë Kosovë dhe atë në emër të tifozëve "Pampurats" të cilët nuk kanë status juridik të OJQ-së. Komuna ka aprovuar subvencion në kundërshtim me natyrën e lejit të subvencioneve për kategorinë në fjalë dhe ka tejkaluar limitet e subvencionimit të personave fizik dhe familjeve sikur është përshkruar në rregulloren komunale për subvencione.

Sipas komunës ky veprim kishte ndodhur shkak i urgjencës kohore dhe pamundësisë për të planifikuar dhe ndjekur procedurat adekuate për të mundësuar organizimin e ceremonisë në fjalë.

**Ndikimi** Subvencionimi i individëve jo në pajtim me ligjet apo rregulloret rrit rrezikun që mjetet për të cilën janë destinuar të mos e arrijnë qëllimin e duhur gjithashtu pamundëson llogaridhënien lidhur me shpenzimin e parasë publike.

**Rekomandimi A5** Kryetari të sigurohet se për subvencionimin e kategorive të caktuara të shoqërisë apo edhe personave juridik janë duke u respektuar të gjitha kërkesat ligjore të cilat rrjedhin nga ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A6 - Dobësi në ekzekutimin e pagesave

**Gjetja** Sipas Rregullës financiare Nr. 01/2023/MF për Shpenzimin e parave publike, përkatësisht Neni 26, paragrafi 1 citon Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozita e LMFPP.

Komuna tek financimi i projektit pjesëmarrja në tryezën e punës me temën "Kthimi dhe ri integrimi i të zhvendosurve në Kosovë", organizuar nga Unioni i Shoqatave të Personave të Zhvendosur dhe Refugjatëve në Mal të

Zi, kishte ekzekutuar pagesën në vlerë prej 1,950€ në mungesë të dokumenteve autentike siç janë Ftesa dhe Agjenda e mbajtjes së tryezës, për të cilat në mungesë të dokumenteve origjinale nuk arritëm të konfirmojmë origjinalitetin e tyre.

Mungesa e kontrolleve efektive të vendosura nga ana e menaxhmentit si dhe mos funksionimi i tyre ishin shkaktarët kryesor për ekzekutimin e pagesës në fjalë.

#### **Ndikimi**

Ekzekutimi i pagesave pa kompletuar dokumentacionin përkatës apo duke mos marrë siguri mbi origjinalitetin e dokumentacionit rrit rrezikun e keqpërdorimit të parasë publike.

#### **Rekomandimi A6**

Kryetari të sigurohet që asnjë shpenzim i parasë publike të mos ndodhë pa përmbushur procedurat dhe rregullat në fuqi në mënyrë që paraja e shpenzuar të arrijë efektin e pritur.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B9 - Mos respektimi i procedurave të parapara me rregullore për financim publik të OJQ-ve**

##### **Gjetja**

Sipas Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 2, paragrafi 1 " Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje. Gjithashtu Neni 20 paragrafi 1, 2 dhe 3.1 Pas përfundimit të vlerësimeve, rezultatet paraprake të vlerësimit publikohen në faqen elektronike të ofruesit të mbështetjes financiare brenda shtatë (7) ditësh, dhe njoftohen me shkrim të gjithë aplikantët. Në këtë fazë Komisioni Vlerësues kërkon nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve paraprake dokumentacionin në vijim: Dëshmi se kanë kryer të gjitha obligimet tatimore dhe kontributet pensionale sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës; ose në rast të ekzistencës së detyrimeve, dëshmia e një marrëveshjeje me autoritetet tatimore për përmbushjen e detyrimeve të tilla.

Në (4) katër raste kemi evidentuar të gjeturat si në vijim:

- Komuna tek financimi i projektit "Mbështetja financiare për klubin e futbollit Fushë Kosova" në vlerë të pagesës 10,000€, dhe "Financimi i shpenzimeve për pjesëmarrje në tryezën e punës me temën Kthimi dhe integrimi i të zhvendosurve në Kosove" në vlerë prej 1,905€, kishte anashkaluar procedurat e përcaktuara në rregulloren për financimin e OJQ-ve duke financuar projektet pa zhvilluar procedura të thirrjes publike.
- Tek procedura e mbështetjes financiare për projektin "Edukimi Social për grupet e fëmijëve me nevoja të veçanta" me vlerë të projektit 3,800€ dhe projekti "Detyrimet etike koleziale në raport me institucionet shëndetësore", vlera e projektit 3,700€ komuna kishte nënshkruar kontratë me OJQ-të të cilat kishin dorëzuar Vërtetimin Tatimor me rastin e aplikimit por si shkak i vonësive në procedurën e vlerësimit, në momentin e kontraktimit Vërtetimet Tatimore ishin të skaduara dhe si të tilla ishin të pa vlefshme.

Këto veprime kishin ndodhur si shkak i mos planifikimit jo adekuat të

buxhetit për financimin e projekteve me OJQ-të.

**Ndikimi**

Anashkalimi i procedurave ligjore, përkatësisht mos-respektimi i kritereve të rregullores për financimin e OJQ-ve, ndikon në zbehjen e parimeve të përgjithshme të financave publike duke kufizuar konkurrueshmërinë, rritë mundësinë për diskriminim dhe rrit rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive.

**Rekomandimi B9**

Kryetari duhet të siguroj që projektet e financimit të OJQ-ve të planifikohen në kohën e duhur në mënyrë që të respektohen kriteret e parapara ligjore për financimin e OJQ-ve, me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,163,741€, prej tyre ishin shpenzuar 4,198,465€ apo rreth 41% të buxhetit final. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve lokale, kanalizime, shpronësime, objekte arsimore e shëndetësore.

#### Çështja B10 - Specifikimi teknik jo i qartë/matshëm

##### Gjetja

Sipas nenit 28.4 të LPP-së, autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim, gjithashtu neni 28.8 Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Dhe sipas 28.7 Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

Çështjet që janë identifikuar te specifikimet teknike janë te projektet në vijim si:

Renovimi i shkollave fillore të mesme të ulët në Fushë Kosovë dhe në fshatra, në vlerë prej 242,242€, në formulimin e specifikave teknike ishin bërë përkthime jo të sakta dhe jo të matshme të pozicioneve si:

- Nuk është përcaktuar standardi i cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara, duke kërkuar vetëm furnizime me material, transporti dhe muratimi, sipas projektit, i mureve të brendshme, me blloqe prej argjilës së pjekur, por pa përcaktuar numrin e ndarjeve të brendshme të bllokut (dhomave termike të bllokave);
- Furnizimi, transporti dhe vendosja e konstruksionit të drurit sipas projektit, por pa përcaktuar profilin e trajve të drurit (edhe pse iu referohet projektit, komuna nuk ka pasur projekt detal të ndërtimit për këtë projekt);
- Furnizimi i materialit dhe instalimi i rrjetit të ngrohjes në klasën e re (6.0m'x9.5m'). Në llogari përfshihet montimi i gypave të çelikut, kthesave të çelikut, saldimit, mbajtësve të gypave ,radiatorët panel, ngjyrosja, ejt. dhe të gjitha pjesët tjera dhe lidhjet e nevojshme për funksionim të ri. Në këtë pozicion nuk është përcaktuar madhësia e radiatorit apo radiatorëve që nevojiten të vendosen në klasë, apo gjatësia e gypave të çelikut për instalimin e rrjetit të ngrohjes në një klasë;
- Furnizimi dhe montimi i dyerve në tualete prej profileve të PVC-ës me trashësi të profilit 7 cm sipas standardeve të EC ose DIN, ISO, por nuk është përcaktuar se cilit standard iu referohet duke e ditur që nuk është vetëm një standard.

Renovimin e shkollës së mesme të lartë Hivzi Sylejmani në Fushë Kosovë në vlerë prej 114,845€, në formulimin e specifikave teknike ishin bërë përkthime jo të sakta dhe jo të matshme të pozicioneve duke mos përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara,

duke kërkuar vetëm:

- Furnizimi dhe montimi i pasqyrave, por pa përcaktuar dimensionet e tyre;
- Furnizimi dhe vendosja e parketit klasik me trashësi  $h=21\text{mm}$  (përfshihet ngjitësi dhe shtresat përkatëse) nuk ka përcaktuar standardin sipas të cilin duhet të jetë parketi në mënyrë që të krahasohet me atestet e kërkuara;
- Evidentimi dhe përmirësimi i sistemit të nxehjes qendrore, është jo i matshëm dhe nuk përcakton se çka duhet të punohet, apo sa metra gyp apo sa radiator duhet të ndërrohen;
- Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të çelikut të zinguar  $\varnothing 50\text{mm}$  komplet me të gjitha pjesët fazonike të nevojshme deri te kutia e hidrantit +kutia e hidrantit të pajiset me të gjitha pajisjet, duke i përcaktuar njësi matëse copë dhe pse kemi të bëjmë me shpërndarje të rrjetit të hidrantit nga furnizimi/burimi i ujit në 18 kuti të hidrantëve;
- Furnizimi dhe vendosja e linoliumit me trashësi  $t=2.0\text{mm}$  me shtresat përkatëse të kualitetit të lartë, në çmim përfshihen anësoret me gjerësi  $b=10\text{cm}$ . Komuna nuk ka përcaktuar standardin apo specifikim teknik të linoliumit por ka kërkuar vetëm linolium 2mm trashësi të kualitetit të lartë. Kualiteti i lartë është term subjektiv dhe jo i matshëm;
- Furnizimi dhe vendosja e parketit klasik me trashësi  $h=21\text{mm}$  (përfshihet ngjitësi dhe shtresat përkatëse), në çmim të përfshihet gërryerja dhe lysterja me tri shtresa me llak të tejdukshëm, i cili plotëson kërkesa dhe standardet për parket i dedikuar për salla të sportit. Të paraqitet atestet e parketit tek Menaxheri i Projektit. Komuna nuk ka përcaktuar standardin sipas të cilin duhet të jetë parketi në mënyrë që të krahasohet me atestet e kërkuara, po ashtu nuk është e përcaktuar se cilat janë shtresat përkatëse. Pra, kemi të bëjmë me një përshkrim teknik jo të matshëm.

Projektet Rikonstruktimi i rrugës Meshari - faza e dytë Fushë Kosovë, në vlerë prej 127,008€ dhe projekti Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra, në vlerë prej 115,447€, në formulimin e specifikave teknike ishin bërë përshkrime jo të sakta dhe jo të matshme të pozicioneve duke mos përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara, duke kërkuar vetëm:

- Furnizimi me material, transporti, shtrirja me finisher dhe ngjeshja e shtresës së bito-zhavorit 0-22mm me trashësi  $t=8\text{cm}$  dhe asfalt - betonit me trashësi  $t=5\text{cm}$ , por pa u përcaktuar standardi i asfaltit apo nivelin e ngjeshjes, pra pa përcaktuar metodën e testimit për matjen e temperaturës së përzierjeve të nxehta bituminoze pas përzierjes dhe gjatë ruajtjes, transportit dhe shtrimit.

Specifikimet teknike jo të qarta/matshme, kanë ndodhur për shkak se njësitë kërkuese nuk kanë bërë rishikim adekuat dhe në mënyrë profesionale, për të eliminuar paqartësitë, dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka ushtruar kontrole të mjaftueshme për të parandaluar këtë mangësi.

## Ndikimi

Mos përcaktimi i saktë i standardit të kualitetit të punimeve apo produkteve të kërkuara ndikon që mbikëqyrja e kontratave të mos jetë efikase dhe punimet të kryhen me kualitet të dobët. Kjo bënë që operatorët ekonomik të jenë të keq orientuar dhe mund të ndikoj në ofertën financiare dhe çmimin e kontratës.

**Rekomandimi B10** Kryetari duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 57,399,097€, pasurive jokatitale është 373,465€ si dhe e stoqeve 375,493€.

### Çështja B11 - Dobësi në procesin e inventarizimit të pasurisë jo financiare

**Gjetja** Sipas nenit 19.4.3 të rregullores Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur. Po ashtu, sipas nenit 4.1 Zytari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën.

Komuna e kishte kryer inventarizimin e pasurisë, mirëpo raporti i procesit të inventarizimit ishte hartuar me vonesë, raporti i inventarizimit ishte hartuar më 30.04.2024 dhe nuk kishte arritë të bëhet harmonizimi/krahasimi me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare të cilat janë prezantuar në PVF.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.

**Ndikimi** Raportimi i vonshëm pamundëson krahasimin raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë. Mos krahasimet e raporteve me regjistrat e pasurive, nuk japin siguri për gjendjen faktike të tyre, më tutje, kjo mund të ndikoj në humbjen apo keqpërdorimin e pasurisë.

**Rekomandimi B11** Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbush kërkesat ligjore në baza të rregullta vjetore, të sigurohet se raporti për kryerjen e inventarizimit të jetë i gatshëm në kohën e përshtatshme para përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



### 2.3.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PVF-të e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,124,063€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 4,741,88€, leje ndërtimore 163,965€, dhe të tjera qiraja 218,990€.

#### Çështja B12 - Dobësi në Menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr. 06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk kishte vendosur politika dhe rregullore për rritjen e efikasitetit në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme, pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Sipas pasqyrave vjetore financiare të vitit 2023, në raport me vitin paraprak, ato janë rritur për 575,852€ apo 13%. Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për mbledhjen/realizimin e llogarive të arkëtueshme. Sfida kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë.

Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

**Ndikimi** Mos arkëtimi në kohë i të hyrave dhe mungesa e marrjes së veprimeve të nevojshme për inkasimin e tyre ka efekt negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake. Gjithashtu, mungesa e veprimeve të mjaftueshme për mbledhjen e të hyrave ndikon në rritjen e rrezikut të vjetërsimit të llogarive të arkëtueshme.

**Rekomandimi B12** Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit, drejtori i NJAB-së dhe një auditor. NjAB për vitin 2022 kishte planifikuar gjashtë auditime ku asnjë nga këto auditime nuk ishin kryer për shkak të kufizimi të fushëveprimit nga menaxhmenti.

#### Çështja B13 - Mos përmbushja e planit vjetor të auditimit

**Gjetja** Sipas planit vjetor të Auditimit të Brendshëm, të datës 22.12.2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm kishte planifikuar të kryej gjashtë (6) raporte të auditimit për vitin 2023.

Njësia e auditimit të brendshëm nuk kishte realizuar asnjë auditim nga gjashtë auditimet që kishte planifikuar për vitin 2023. Me vendim të komisionit disiplinor të datës 14.03.2023, Udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ishte pezulluar përkohësisht nga puna si udhëheqës i NJAB për mos realizim të planit të auditimit dhe atë nga 01.04.2023 deri 31.01.2024, duke kufizuar fushëveprimin e NJAB si trup e pavarur e mbikëqyrjes së kontrollit të brendshëm të komunës dhe duke mos bërë zëvendësimin e udhëheqësit të NJAB.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së komunikimit ndërmjet NJAB-së dhe departamenteve përkatëse. Për më tepër, departamentet që ishin objekt i auditimit të brendshëm nuk i kishin lejuar qasje në dokumentet zyrtare.

**Ndikimi** Mos përmbushja e planit të auditimit të brendshëm, zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve kyçe financiare, sidomos në një ambient organizativ si Komuna e Fushë Kosovës, ku ka një numër të shkollave, institucioneve vartëse apo edhe njësive tjera të cilat krijojnë të hyra dhe shpenzime të cilat do të duhej t'i nënshtroheshin një numri auditimesh të kohëpaskohshme. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive.

**Rekomandimi B13** Kryetari duhet të sigurojë se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Njëkohësisht të sigurohet se auditorëve të iu ofrohet bashkëpunimi i duhur dhe qasje në informata me qëllim të përmbushjes së planit vjetor të punës të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A7 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit****Gjetja**

Sipas UA MF- Nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit (KA) në subjektin e sektorit publik, përkatësisht neni 8 parasheh që KA duhet të mbajë së paku katër mbledhje brenda vitit kalendarik, për të shqyrtuar rekomandimet nga raportet e Auditimit të Brendshëm dhe Auditimit të Jashtëm dhe neni 7 përcakton përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit ku, paragrafi 1 pika 5 ndër tjera përcakton se KA mbikqyrë dhe vlerëson performancën e aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit të miratuar përmes raporteve periodike nga udhëheqësit e Njesisë së auditimit të brendshëm.

Për vitin 2023, Komiteti i Auditimit kishte mbajtur vetëm dy (2) takime duke vështirësuar mbështetjen profesionale për Kryetarin në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes së NJAB-së. Me vendim të Kryetarit, Komiteti i Auditimit kishte pushuar së funksionuari nga muaji gusht 2023.

Ne nuk kemi pranuar nga komuna se cilat ishin shkaqet e mos funksionimit të Komitetit të Auditimit. Megjithatë vërehet se problemet e brendshme dhe mungesa e komunikimit të mirëfilltë kishte pamundësuar funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit.

**Ndikimi**

Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit, ndikon negativisht në efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës përkatësisht në mbikëqyrjen e realizimit të planit të Auditimit nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

**Rekomandimi A7**

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e komitetit të auditimit që të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>9</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>15,093,936</b>	<b>23,252,917</b>	<b>16,628,215</b>	<b>10,322,043</b>	<b>11,330,648</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	11,288,534	12,989,550	12,344,937	7,810,357	8,553,540
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	78,319	26,051
Të bartura nga viti i kaluar	0	6,354,114	2,849,798	1,719,704	1,290,847
Të hyrat vetanake	3,805,402	3,805,402	1,380,788	697,432	1,429,671
Donacionet vendore	0	99,851	48,692	16,230	30,494
Donacionet e jashtme	0	4,000	4,000	0	44

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 8,158,981€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së garantit prej 1,701,016€, nga të hyrave të bartura nga viti paraprak 6,354,114€, rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme me 103,851€.

Në vitin 2023 Komuna e Fushë Kosovës ka shpenzuar 71% të buxhetit përfundimtar, me një realizim më të mirë prej 10% në krahasim me vitin 2022, ku realizimi ishte 61%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>15,093,936</b>	<b>23,252,917</b>	<b>16,628,215</b>	<b>10,322,043</b>	<b>11,330,648</b>
Pagat dhe mëditjet	6,155,552	8,050,065	7,978,820	5,011,121	5,541,220
Mallrat dhe shërbimet	2,432,982	3,178,467	2,711,211	2,109,187	1,915,638
Komunalitë	260,000	260,000	258,388	358,896	252,761
Subvencionet dhe transferet	960,402	1,600,643	1,481,331	1,144,208	744,990
Investimet Kapitale	5,285,000	10,163,741	4,198,465	1,698,631	2,876,037

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


-Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,894,513€. Kjo rritje është: 1,701,015€ nga Granti qeveritar dhe 193,498€ nga të hyrat të bartura nga viti paraprak.

-Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 745,485€. Ky ndryshim buxhetor është nga të hyrat e bartura në shumë 745,485€.

-Buxheti final për subvencione kishte rritje për 640,241€, nga të hyrat e bartura në shumë 543,180€ dhe nga donacionet 97,061€.

-Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 4,878,741€. Kjo rritje ishte nga të hyrat e bartura në shumë 4,871,951€ dhe nga donacionet 6,790€. Një pjesë e kësaj rritje të buxhetit është dedikuar për projektet të reja si sera bujqësore e participim, mjete konkretizimi, pajisje të teknologjisë informative.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2023 ishin në vlerë prej 3,354,157€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, në vlerë prej 1,489,471€, (në këtë shumë përfshihet edhe Tatimi në Tokë), si dhe të hyrat tjera jo tatimore në vlerën prej 1,894,628€ ( të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Në totalin e të hyrave të realizuara janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në Trafik në vlerë prej 846,465€, gjobat e Gjykatave 13,240€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 792€.


**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>3,805,401</b>	<b>3,805,401</b>	<b>3,354,157</b>	<b>2,935,112</b>	<b>3,936,449</b>
Të hyrat tatimore	1,255,080	1,255,080	1,489,471	821,865	1,031,471
Të hyrat jo tatimore	2,550,321	2,550,321	1,864,687	2,113,098	2,904,045
Të hyrat tjera	0	0		149	932

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Komunës së Fushë Kosovës ka rezultuar në 14 rekomandime kryesore. Komuna e Fushë Kosovës kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna kishte mbajtur dëgjim publik lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, një (1) rekomandime ishte zbatuar, ndërsa 13 rekomandime nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Ne kemi hasur shpenzime që ishin regjistruar në kategori jo adekuate gjatë viti 2023	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të rris performancën e angazhimit tek stafi dhe përmirësoj komunikimin në mes departamenteve, që të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë, në mënyrë që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim edhe këtë vit komuna nuk kishte regjistruar të gjitha pasuritë.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestnim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Edhe këtë vit kemi hasur që janë bërë pagesa duke përdorur fonde nga projektet jo për të cilat ishin të aprovuara.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të procedurave të prokurimit për investimin e parasë publike të mos përfshihen në dosje të tenderit investimi i parasë publike në prona private por ato të shpenzohen vetëm për qëllime publike.	Nga mostrat e testuara ne nuk kemi vërejtur se komuna kishte investuar në prona private.	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim duke bërë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim edhe këtë vit komuna kishte punëtor jashtë listës së pagave, rekomandimi nuk ishte zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që projektet e financimit të OJQ-ve të planifikohen në kohën e duhur në mënyrë që të respektohen kriteret e parapara ligjore për financimin e OJQ-ve, me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim edhe këtë vit komuna kishte subvencionuar OJQ pa procedura adekuate	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se kontrolle janë efektive dhe monitorojnë zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprkishtë të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet edhe në vitin 2023 komuna kishte inicuar procedura të prokurimit pa plan detal të ndërtimit.	Nuk ka filluar zbatimin



9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që nuk do të ketë tejkalime të pozicioneve mbi limitet e lejuara me ligj.	Edhe gjatë vitit 2023 në një rast kemi hasur që komuna kishte bërë ndryshimin e kontratës mbi limitin ligjor	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Nuk janë ndërmarrë veprimet edhe në vitin 2023 në procedurat e iniciuara të prokurimit kemi hasur që Specifikimi teknik ishte jo i qartë/matshëm.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbush kërkesat ligjore në baza të rregullta vjetore, të sigurohet se raporti për kryerjen e inventarizimit të jetë i gatshëm në kohën e përshtatshme para përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim duke bërë inventarizimin.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim duke ndërmarr masa të nevojshme për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh me qëllim të mos ketë shpenzime shtesë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet ku nga mostrat e testuar kemi vërejtur se komuna nuk i kishte bërë pagesat e faturave brenda afatit kohor se kishte pagesa përmes procedurave gjyqësore/përmb aruesve.	Nuk ka filluar zbatimi

14.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Njëkohësisht të sigurohet se auditorëve të iu ofrohet bashkëpunimi i duhur dhe qasje në informata me qëllim të përmbushjes së planit vjetor të punës të Njesis së Auditimit të Brendshëm.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim në mënyrë NJAB të realizoj planin duke hartuar raporte të auditimit.	Nuk ka filluar zbatimi
-----	----------------------	--	--	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Albana Sahiti, Anëtare e ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>Komenti ynë: Në vitin 2023 ne jemi nënshtruar një pune të vështirë për shkak se ka pasur vonesa të mëdha të Bartjes së Buxhetit nga THV (2021-2022 në muajin korrik dhe gusht 2023), pastaj nuk ka pasur Rishikim të buxhetit për vitin 2023. Sa i përket Projektit të Bashkëfinancimit zyra e financave ka pranuar vendimin nga Kuvendi i Komunës me nr. 64 me date 06.03.2023 i cili është miratuar me shumice votash.</p> <p>Në baze të këtij Vendimi zyra e financave ka qenë e obliguar të bejë zotimin e mjeteve sipas zërave të parapara në Vendim. Sa i përket implementimit të projektit ka qenë zyra e Bujqësisë ne vetëm kemi zbatuar Vendimin e Kuvendit.</p> <p>Keq klasifikimi ka ndodh edhe për shkak të inflacionit dhe vështirësive me operatoret ekonomike si pasoje e rritjes së shpenzimeve të tyre.</p>	E gjetura qëndron, nga testimet tona është konfirmuar se vlera e pagesave e paraqitur në këtë çështje janë shpenzime me klasifikim jo adekuat e të cilën edhe komuna e konfirmon me komentin e saj.

<p>Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PVF</p>	<p>Komenti ynë - Janë regjistruara pasurit në vlerë 234,560€, Zyrtaari i pasurisë gjate vitit 2023 ka zëvendësuar zyrtaren çertifikuese, respektivisht ka qenë i ngarkuar për shkak të vëllimit të madh të lendeve. Në vitin 2024 është bërë korrigjimi respektivisht regjistrimi dhe ndryshimi i statusit në SIMFK-se i lendës me ID 113111 shuma 20,512.00€, ID 113107 shuma 143,176.50€, ID 113068 shuma 50,000.00€, ID 113945 shuma 19,932.20€ (sipas vlerës se faturës pa shpenzime përmbartimore), ID106065 shuma 138,390.00€ është bërë ndryshimi i statusit Investim ne vijim i Mbyllur.</p> <p>Ne jemi të bindur plotësisht që me këtë informacion shtesë kjo e gjetur do të hiqet në raportin final. (Te bashkangjitura gjeni raportet e pasurisë së regjistruar dhe ndryshimin e statusit Investim ne vijim i Mbyllur ne SIMFK-se).</p>	<p>E gjetura qëndron, pasurit e identifikuar si të pa regjistruara gjatë vitit 2023 komuna e konfirmon se i ka regjistruar në vitin 2024.</p>
<p>Dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore</p>	<p>Komenti ynë - Qeveria në bazë të kërkesave tona të vazhdueshme, në vitin 2023 ka ndarë mjete në kategorinë ekonomike Paga dhe shtesa për të ekzekutuar Vendimet Gjyqësore, por jo mjete të mjaftueshme për të trajtuar pagesat që burojnë nga kontrata kolektive. Ky problem shumëvjeçar ka dëmtuar komunën tonë në mënyrë të vazhdueshme por është jashtë kompetencës sonë për ta zgjidhur. Kështu e gjetura nuk mund të përmirësohet dhe rekomandimi nuk mund të zbatohet derisa kjo nuk është kompetencë e komunës. Pra nga shuma e tërësishme prej 1,076,751€€ të ekzekutuar nga Thesari 939,725€ rreth 87% janë vendime gjyqësore dhe përmbartimore për të cilat komuna nuk ka asnjë autoritet për të planifikuar buxhet, për të paguar apo për të ndryshuar pagesat nga kontrata kolektive derisa kjo të mos rregullohet në buxhetin tonë nga ana e Qeverisë.</p> <p>Sqarim: Nga gjithsej pagesa (Vendime Gjyqësore dhe</p>	<p>E gjetura qëndron, nga llogaria e komunës janë ekzekutuar pagesat për vendimet gjyqësore për paga sipas kontratën kolektive apo për fatura që komuna nuk i kishte paguar brenda afatit të përcaktuar kohor, ku këto pagesa kishin shpenzime shtesë të procedurës përmbartimore apo interesit. Komuna e konfirmon këtë por nuk pajtohet që jan për shkakun e komunës pasi që komuna pretendon se nuk është nënshkruese e kontratës kolektive.</p>

Përmbareme) për kontratën kolektive shuma 939,725€, në kategorinë ekonomik Paga dhe shtesa ( kodi ekon. 11900) janë ekzekutuar shuma 776,670.34€, kurse shuma 141,755€ në kategorinë ekonomike Mallra ( kodi ekon. 14410) dhe 21,300€ ne kategorinë ekonomike Kapitale ( kodi ekon. 34000).

Ne mendojmë që e gjetura duhet të rishikohet dhe të mbahet në raport por vetëm për shumën e pagesës së operatoreve ekonomik 137,025€ për të cilat ne duhet të mbahemi përgjegjës por asesi për shumën 939,725€.

Si pasoje e vonesës në pagesën e detyrimeve financiare komuna ishte detyruar te paguante shpenzime shtese prej 171,556€ në emër të procedurës kontestimore/përmbareme apo interesit për pagese te vonuar.

Ne jemi të bindur plotësisht që me këtë informacion shtesë kjo e gjetur do të hiqet në raportin final.

Çështja	Komenti i OB	Pikëpamja e ZKA-së								
<p><b>Çështja A3 – Perzgjedhja e operatpreve ekonomik te papergjegjeshem, gjate vleresimit te ofertave ne procedurat e prokurimit</b></p>	<p>Komenti ynë - Lidhur me pretendimet tuaja se ne si AK kemi bere vlerësim jo korrekt, për ti vlerësuar me kujdes ofertat dhe për ti analizuar dëshmitë e ofruara në raport me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit janë të pabazuara. Ne si AK ju dëshmojmë se kemi bërë vlerësim korrekt dhe kemi analizuar detajisht të gjitha dëshmitë e ofruara nga GOE, i cili është shpërblyer me kontrate pasi që ka plotësuar në përpikëri kriteret e përcaktuara nga ne si AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate.</p>	<p>Sipas nenit 26.6 Rregullores nr. 001/2022, Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përbush standartet përkatëse. Ne kemi vërejtur se OE fitues, në listën e çertifikatave ISO të ofruara kishte siguruar vetëm ato të partnerit të dytë të koncorziumit/Grupit të Operatorëve Ekonomik ofertues, por jo edhe të partnerit të parë apo kryesor. Pra nuk kanë qenë të dy anëtarët e konsorciumit të pajisur me certifikatat e kërkuara me dosjen e tenderit.</p>								
	<table border="1"> <tr> <td>7.1&amp;7.2 Përshtatshmëria profesionale:</td> <td>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</td> </tr> <tr> <td>1.Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.</td> <td>1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e juaj të themelimit me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend – kopja e numrit unik identifikues ose çertifikatës së biznesit.</td> </tr> <tr> <td>2.Certifikata e regjistrimit për TVSH.</td> <td>2. Kopja e çertifikatës se regjistrimit për TVSH (deklarues).</td> </tr> <tr> <td>3. OE duhet te ofroj certifikatat si ne vijim a) ISO 9001 2015 , b) ISO 14001 2015 , c) ISO 45001 2018</td> <td>3. Si deshmi kopja e a) ISO 9001 2015 b) ISO 14001 2015 c) ISO 45001 2018</td> </tr> </table>		7.1&7.2 Përshtatshmëria profesionale:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:	1.Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.	1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e juaj të themelimit me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend – kopja e numrit unik identifikues ose çertifikatës së biznesit.	2.Certifikata e regjistrimit për TVSH.	2. Kopja e çertifikatës se regjistrimit për TVSH (deklarues).	3. OE duhet te ofroj certifikatat si ne vijim a) ISO 9001 2015 , b) ISO 14001 2015 , c) ISO 45001 2018	3. Si deshmi kopja e a) ISO 9001 2015 b) ISO 14001 2015 c) ISO 45001 2018
	7.1&7.2 Përshtatshmëria profesionale:		Dëshmia e kërkuar dokumentare:							
	1.Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.		1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e juaj të themelimit me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend – kopja e numrit unik identifikues ose çertifikatës së biznesit.							
2.Certifikata e regjistrimit për TVSH.	2. Kopja e çertifikatës se regjistrimit për TVSH (deklarues).									
3. OE duhet te ofroj certifikatat si ne vijim a) ISO 9001 2015 , b) ISO 14001 2015 , c) ISO 45001 2018	3. Si deshmi kopja e a) ISO 9001 2015 b) ISO 14001 2015 c) ISO 45001 2018									
<p>Ne si AK Vlerësojmë se GOE fitues është bërë në pajtueshmëri të plotë me LPP-ne dhe Rregulloren për prokurim publike , respektivisht nenet e mëposhtme:  <b>Neni 66 pika 2 Përshtatshmërie Profesionale-</b> Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se</p>										

	<p>një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.</p> <p><b>Neni 69 pika 5 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale</b> - certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.</p> <p><b>Neni 71 Pika 4- Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e huaj Ekonomik.</b> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. <b>Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.</b></p> <p><b>Pra, ne si AK kemi vepruar në përputhshmëri të plote me LPP-në, pasi që bazuar në Nenin 71 pika 4 të LPP-se. Çdo kërkesë e vendosur nga ne si AK sipas neneve 66.2 dhe sipas nenit 69 ku përfshihen edhe certifikatat për kontrollimin e cilësisë, nuk e përjashton nga pjesëmarrja OE-ne pjesë e konzerciumit në aktivitetin e prokurimit pasi që kriteret e vendosura aplikohen ndaj grupit si entitet dhe jo ndaj anëtarëve individual.</b> Gjithashtu ne kemi vepruar në përputhshmëri të plote me rregulloren 001/2022, <b>Pika 26.5</b> - Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzojë Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. <b>Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.</b></p> <p>Pra, vlerësimi jonë është në përputhje të plotë me Nenin 26.5 të rregullores për prokurim publik pasi që kemi vlerësuar grupin si tërësi dhe jo anëtarët individual dhe në përputhje të plotë me nenin 71 pika 4 e LPP.</p> <p>Ne marrëveshjen për bashkëpunim të dorëzuar nga GOE në pikën 3 specifikisht tek Veprimtaria dhe Përgjegjësitë e GOE theksohet se:</p>	
--	---	--




	<p>a) Bashkëpunimi i dy kompanive nënkupton se të dyja kompanitë mbajnë përgjegjësi të plotë për projektin e lartpërmendur.</p> <p>b) Aktiviteti dhe bashkëpunimi i të dyja kompanive është i pakufizuar për projektin në fjale, Të gjithë hapat që ndërmerren gjatë kryerjes së punimeve duhet të jenë të koordinuara dhe do të ketë shërbim informacionesh nga të dyja palët.</p> <p>c) Të gjitha vendimet e rëndësishme si dhe vendimet tjera duhet të ndërmerren nga të dy partneret me marrëveshje interne.</p> <p>Pra, nëse në marrëveshjen e GOE është cekur e bashkarisht do të kryejnë shërbimet mjafton që njeri anëtar i grupit të jetë i certifikuar me ISO.</p> <p>Çështja juaj e ngritur duke u bazuar ne Piken 26.6 te rregullores është e pa bazuar, pasi që ky nen aplikohet vetëm nëse kërkesat specifike për certifikatat e cilësisë janë të qarta dhe specifike në dosjen e tenderit që secili anëtar duhet të ketë certifikatat ISO 9001-2015 , ISO 14001- 2015 dhe ISO 45001- 2018 gjë që në rastin tonë këto kërkesa nuk janë specifikuar (nuk janë kërkuar për të gjithë anëtarët e GOE).</p> <p>Neni 17.12 i Rregullores nr. 001/2022, për prokurim publik e përcakton qartë se çka është dosja e tenderit, si në vijim :</p> <p>17.2 “ Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është material themelorë, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre “.</p> <p>Përderisa nuk ka qenë e përcaktuar një gjë e tillë, atëherë nuk mund të eliminohet nga konkurrenca një grup i OE nëse njeri prej tyre i ka ofruar, kurse anëtarët e tjerë jo. Një veprim i tillë do të binte ndesh me nenin 56.3 te LPP-se ku përcaktohet si në vijime;</p> <p>3.Tenderusi gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit .</p> <p>Ne këtë rast nuk ka qenë i përcaktuar një kriter se nëse ofertohet në grup atëherë të gjithë anëtarët duhet ti</p>	
--	--	--

	<p>ofrojnë dëshmitë për ISO certifikata, prandaj edhe nuk kemi mundur të eliminojmë grupin e OE me një arsyetim të tillë.</p> <p>Çështjen se duhet të përcaktohen qartë kërkesat që duhet ti përmbush grupi dhe dëshmitë që duhet ti ofroj grupi i OE, e ka sqaruar edhe interpretimi i KRPP-se tek pyetjet e shpeshta konkretisht pyetja numër 29 e datës 22.06.2023 ku interpretohet si në vijim ;</p> <p>Ne përputhje me nenin 71 te LPP-se, si dhe nenin 26.10 të Rregullores së prokurimit publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do ti specifikoj qartë kërkesat që duhet ti përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit ) duke përcaktuar çartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre.</p> <p>Po ashtu sqarojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve bëhet vetëm duke u bazuar ne kërkesat e dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë, kurse neni 59.4 i LPP-se përcakton çartë si ne vijim;</p> <p>4.Autoriteti kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjale është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.</p> <p>Mbi këtë bazë dhe mbi këtë dispozite, kuptohet se oferta e OE -se nënshkrues të kontratës ka qenë në përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe nuk kemi mundur të dalim jashtë kërkesave të dosjes së tenderit .</p> <p>Sqarojmë se grupi i OE -se të rekomanduar për kontratë ka qenë ofertuese i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.</p> <p>Po ashtu sqarojmë se neni 59.4 pika (ii) parasheh edhe devijimet e vogla që mund të konsiderohen dhe të mirren parasysh gjatë vlerësimit të tenderëve, kur këto devijime nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet , dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen tenderit.</p> <p>Devijimet e vogla të tilla mund të merren parasysh sidomos kur është në pyetje ekonomiciteti sipas nenit 6 te LPP-se dhe qëllimi i LPP-e sipas nenit 1 te LPP-se është të siguroj mënyrën ma efikase me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.</p> <p>Pra, vlerësimi jonë është në përputhje të plotë me Nenin 26.5 te rregullores për prokurim publik pasi që kemi</p>	
--	---	--

	<p>vlerësuar grupin si tërësi dhe jo anëtarët individual dhe në përputhje të plotë me nenin 71 pika 4 e LPP. Pra nëse në marrëveshjen e GOE është cekur e bashkërisht do ti kryejnë shërbimet mjafton që njeri anëtar i grupit të jetë i certifikuar me ISO.</p> <p><b>Përmbledhje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Neni 71 Pika 4- Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e huaj Ekonomik</b> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. <b>Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.</b></li> <li>• <b>Neni 26.5:</b> Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit. <b>Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.</b></li> <li>• Pretendimi se është bërë shkelje e nenit 26.6 të rregullores për prokurim publik është e pa bazuar, pasi që ky nen aplikohet vetëm nëse kërkesat specifike për certifikatat e cilësisë janë të qarta dhe specifike në dosjen e tenderit që secili anëtar duhet të ketë certifikatat, gjë që në rastin tonë nuk janë specifikuar.</li> <li>• Derisa në marrëveshjen e GOE është cekur se bashkërisht si grup do ti kryejnë të gjitha shërbimet, atëherë mjafton që vetëm njeri prej anëtarëve të grupit të jetë i certifikuar me ISO standarde të cilësisë.</li> </ul>	
--	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çështjen se duhet të përcaktohen qartë kërkesat që duhet ti përmbush grupi dhe dëshmitë që duhet ti ofroj grupi i OE, e ka sqaruar edhe interpretimi i KRPP-se tek pyetjet e shpeshta konkretisht pyetja numër 29 e datës 22.06.2023 ku interpretohet si në vijim: <b>Në përputhje me nenin 71 të LPP-se , si dhe nenin 26.10 të Rregullores së prokurimit publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do të specifikoj qartë kërkesat që duhet ti përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit ) duke përcaktuar çartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre.</b></li> </ul>	
--	---	--



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Fushë Kosovës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- nuk pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet, komentet i kemi dorëzuar për përmbajtjen e Raportit PFV 2023;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Burim Berisha

(Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës)

Data: 18. qershor. 2024 Fushë Kosovë,

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>10</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>11</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Renovim i Objektivit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 36,536€; Kompensimi për Inflacion në bazë të Vendimit të Qeverisë në Ligjin Nr.08/L-183 të datës 25.11.2022 dhe vendimit të Komunës me Nr.prot.753 të datës 30.06.2023, 22,569€, Specifikacion Vgj, 50,010€; Ndërtimi i Objektivit në QKMF Miradi e Poshtme 9,653€; Specifikacion Vgj, 28,725€; Renovim i jashtëm të Objektivit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 19,323€. Nga investimet kapitale: Ndërtimi i shtëpive për familjet në nevojë 15,286€, Blerja e folive me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 13,800€, Eliminimi i deponive ilegale 13,330€, Blerja e plehut azotik bujqësor me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 14,752€, Blerja e serave me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 23,059€, Furnizim me inventar për Shkollën Filllore Mihail Grameno 10,721€, Furnizim me Laptop për Shkollat Publike Filllore dhe të Mesme në Komunën e Fushë Kosovës 119,307€, Blerja e moto kultivatorëve me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 49,896€, Furnizimi, Transporti dhe Montimi i 200 ulëseve dhe 200 shportave për parqe dhe hapësira tjera publike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës 55,800€, Blerja e kontejnerëve metalik-vendosja e shportave 43,500€, Blerja e mekanizmit bujqësor me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 60,560€, Blerja e mekanizmit bujqësor me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 35,790€, Furnizim me projektor dhe pajisje përcjellëse për Shkolla Publike Filllore dhe të Mesme 138,390€, Vendim gjyqësor 5,633€. Nga Subvencionet: Ndërtimi i objektit publik me karakter shoqëror në fshatin Henc, 7,855€, Vendimi i kuvendit komunal nr. 160 datës 08/09/2023 me vlerë 43,661€.
- <sup>6</sup> 1. Mirëmbajtja e ndriçimit publik 20,512€; Vendime Gjyqësorë, 20,871€; Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Sllatinë e Vogël 143,176€; Renovimi i objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, 50,000.00€. 2. Transporti dhe montimi të 200 ulëseve dhe 200 shportave për parqe dhe hapësira tjera publike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës 55,800€, Furnizim me projektor dhe pajisje përcjellëse për shkolla publike, filllore dhe të mesme, 138,390€.
- <sup>7</sup> Mbivlerësimi i Detyrimeve Kontigjente: Lënda P.nr 817/22- 218,725€, Lënda C.nr.2486/13- 7,573€. Nënvlërësimi i Detyrimeve Kontigjente: Lënda C.nr.1476/16- 11,233€, Lënda C.nr.1528/19- 3,600€, Lënda C.nr.3117/19 - 2,899€.
- <sup>8</sup> Ndërtimi i shtëpive të banimit për familjet skamnore 15,286€, Eliminimi i deponive të egra 13,330€, Rregullimi i fushës së sportit me bari sintetik në fshatin Harilaq 11,145€, Ndërtimi i urave në Fushë Kosovë, Henc, Sllatinë e Vogël dhe Pomozotin 39,232€, Ndërtimi vendosja e kubëzave në trotualet e territorit të Komunës së Fushë Kosovës 27,571€, Vendime gjyqësore 20,871€, Blerja e mekanizmit bujqësor me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 60,560€, Blerja e mekanizmit bujqësor me destinim për të ndihmuar fermerët e Komunës së Fushë Kosovës 35,790€, Ndërtimi dhe vendosja e pikave grumbulluese të mbeturinave në Fushë Kosovë 7,370€, Furnizim me aparatura dhe pajisje mjekësore për institucionet në shëndetësi 40,553€; Furnizim me aparatura dhe pajisje mjekësore për institucionet shëndetësore 17,758€, Furnizim me aparatura dhe pajisje mjekësore për institucionet shëndetësore 12,888€, Zhblllokim i kanalizimit, furnizim me montim kapakëve, tërheqje e ujërave atmosferike nëpër bodrume 5,080€; Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit - Turqi 7,454€;
- <sup>9</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>10</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>11</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.